

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E premte, 14 janar 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30 paradite

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita.

6 Mirë se erdhët të gjithë.

7 Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar

9 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-07, Prokurori i
10 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Halling,
12 keni ndryshim në përbërje të ekipit?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Bowden,
15 ka ndryshime në ekipin tuaj?

16 Z. BOWDEN: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës. Siç e
17 shihni zoti Gucati është me ne sot. Mori barna shtesë dje. E
18 vizitojë një mjek. Do ta shikoj prapë një infermiere, I janë
19 dhënë medikamente të tjera. Vlerësohet se është në gjendje të
20 marrë pjesë në proces sot, por duke pasur parasysh edhe
21 këshillën që nëse i krijohen dhimbje gjatë ditës sot, ai do të
22 njoftojë Trupin Gjykses dhe të merren vendimet përkatëse.

23 Zotit Gucati i janë dhënë udhëzime të qarta nga unë vetë sot
24 paradite që ta bëjë këtë gjë dhe do të na komunikojë dhe neve.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 Zoti Cadman, ka ndryshim.

2 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, nuk ka ndryshime. Është një
3 anëtare e ekipit zonja Bernabeu, e cila do të largohet gjatë
4 pushimit të parë sot. Po kam dhe një çështje që do ta
5 diskutojmë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më vonë.

7 Gjykatësi Mettraux vazhdon që të paraqitet përmes
8 platformës Zoom.

9 Mirëmëngjes, zoti Gjykatësi Mettraux.

10 Vërejmë se zoti Gucati dhe zoti Haradinaj janë të
11 pranishëm në sallë.

12 Zoti Haradinaj është ulur në vendin e dëshmitarit.

13 Zoti Gucati, më bëhet qejfi që jeni në sallë sot,
14 shpresoj të jeni më mirë sesa dje. Dhe lirisht, njësoj si më
15 përpara, mund të ngriheni në këmbë nëse është e nevojshme
16 gjatë ditës kur ta keni nevojën dhe shpresoj që të jeni me ne
17 sot.

18 I AKUZUARI GUCATI: Faleminderit shumë. Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
20 vazhdojmë, Trupi Gjykses dëshiron të dëgjoj palët në lidhje
21 me planin si vijon sa i takon dëshmisë së zotit Reid.

22 Po përpara kësaj, kishit diçka që donit të shtoni, zoti
23 Cadman?

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Shkurt. I kam përmend edhe
25 Prokurorisë, është vendosur një dokument shtesë në listën e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 3

1 prezantimit mbrëmë. Ne nuk jemi 100 për qind të sigurtë nëse
2 do ta përdorim apo jo. Kam informuar Prokurorinë që s'do e
3 përdorim.

4 E dyta është, që shtojca e deklaratës së dëshmitarit të
5 sotëm është vendosur gabimisht në listën e prezantimit të
6 Haradinajt. Shpresoj që kjo të mos shkaktoj shumë vështirësi.
7 Por do të sigurohem më pas që ta vendosim në listën e
8 prezantimit të atij dëshmitari.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për sa kohë
10 që është protokolluar mund ta rregullojmë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Ne nuk shikojmë një listë
12 prezantimi për dëshmitarin tjetër për t'i lëvizur këto ku ta
13 çojmë këtë dokument.

14 Z. CADMAN: [Përkthim] Do ta zgjidhim këtë sot paradite.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
16 vazhdojmë.

17 Pra, kemi një mënyrë sesi ta zgjidhim dëshminë e zotit
18 Reid që e kërkon edhe vendimi i Gjykatës së Apelit; është
19 Dëshmitari 1253.

20 Dua që të prezantoj njëherë metodën e punës dhe pastaj do
21 t'ju pyes nëse është e pranueshme për të dyja palët.

22 Dëshmitari duhet të jetë i gatshëm më 24 dhe 28 janar
23 midis orës 8.00 të mëngjesit sipas orës së Hagës deri në orën
24 12.00 të drekës po sipas orës së Hagës. Që është ora 5.00
25 pasdite deri në orën 9.00 në darkë në vendbanimin e

1 dëshmitarit në Australi.

2 Trupi Gjykses është në dijeni se dëshmitari ka të
3 planifikuar vaksinimin në datën 28, por kjo është e vetmja
4 datë e mundshme për të dëshmuar dëshmitari, prandaj presim
5 prej tij që të veprojë në përputhje me sa kërkojmë. Kjo do të
6 thoshte se seancat e datave 24, 28 janar do të fillojnë në
7 orën 8.00 me orën tonë dhe do të bëjmë pushim gjysmë ore, në
8 orën 9.30 dhe pastaj do të vazhdojmë për dy orë të tjera duke
9 filluar nga ora 10.00 e paradites deri në orën 12 të drekës
10 dhe kjo do të ishte dëshmia e tij për këto ditë.

11 E di se kjo është më e vështirë për përkthyesit dhe të
12 gjithë të tjerët, por janë kushtet e veçanta të kësaj situate
13 që kërkojnë fleksibilitet nga ana e të gjithëve. Në rastin më
14 të mirë, dëshmitari do të dëgjohet me videolidhje në të dyja
15 ditët sipas rregullit 144 dhe direktivës së punës për
16 videolidhjet. Por nëse videolidhja nuk mund që të organizohet
17 deri në datë 24, në datë 28, dëshmitari do të dëgjohet përmes
18 Zoom-it në ato data.

19 Trupi Gjykses shpreson, që të paktën më datë 28 ta kemi
20 videolidhjen gati për çdo seancë private që do jetë e
21 nevojshme apo për të treguar dokumente konfidenciale nëse do
22 të jetë e nevojshme. Në çdo rast, Trupi Gjykses u thotë palëve
23 që të paraqesin listën e prezantimit për këtë dëshmitar përmes
24 Zyrës Administrative. Për të organizuar këtë, udhëzohen palët
25 që të dërgojnë listën e prezantimit Zyrës Administrative në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 5

1 kohën e duhur përpara fillimit të kësaj dëshmie, në mënyrë që
2 Zyra Administrative t'ia tregojë ato dëshmitarit.

3 Kjo duhet bërë përmes instrumenteve të sigurta të ndarjes
4 së skedarëve.

5 Dëshmitari urdhërohet që të mos nxjerrë asnjë informacion
6 konfidencial nga këto dokumente. Ne e dimë që zoti Reid i
7 kupton për nga përvoja e punës këto praktika pune.

8 Zoti Cadman, do ju pyes ju. A është kjo një metodë e
9 përshtatshme, e pranueshme për këtë dëshmi?

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Po. Nga ana ime është e pranueshme.
11 Sigurisht, do të më duhet që të konsultohem me zotin Reid. Jam
12 i sigurt që ai do të bëjë çmos që t'i respektojë këto kërkesa.
13 Unë nuk e di pastaj nëse ai vaksinën do ta bëjë paradite apo
14 pasdite. Nuk e di nëse vaksina do ketë ndonjë efekt anësor,
15 por do shikojmë do përpiqemi të jemi sa më fleksibël.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbase do t'i
17 duhet të ndryshojë orën, nëse është e nevojshme, sepse kaq
18 mund të bëjmë, mund të ofrojmë.

19 Zoti Bowden?

20 Z. BOWDEN: [Përkthim] Nuk na shkakton asnjë vështirësi
21 neve.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Halling?

23 Z. HALLING: [Përkthim] I vetmi problem që kishim ne për
24 propozimin tuaj është që ju do t'i jepni njoftim paraprak
25 dëshmitarit për materialet që kemi, pavarësisht, nëse do t'i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 6

1 përdorim apo jo. A mund të kemi një pushim të shkurtër midis
2 pyetjeve nga pala thirrëse dhe kundërpjetjeve në mënyrë që t'i
3 japim në atë moment?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk besoj që
5 është e mundshme. Mbase vetëm një ditë përpara. Çdo gjë që
6 duhet që mund të përdorni duhet t'ia dërgoni. Duhet të
7 tregohemi fleksibël, nëse do ta realizojmë këtë.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull. Për aq kohë sa mund të
9 jemi fleksibël patjetër.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Po unë
11 dua të di a është e pranueshme apo jo?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Çdo gjë tjetër në masat
13 organizative është e pranueshme.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo çdo gjë
15 tjetër. Unë pyes a mund të vazhdojmë apo jo sepse do të lëshoj
16 urdhër pas një minute.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Është e pranueshme nëse ne mund
18 t'ia tregojmë materialet dëshmitarit përmes një pushimi të
19 shkurtër midis pyetjeve nga pala thirrëse dhe kundërpjetjeve.
20 Nëse do ishte kjo?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju po më
22 kërkoni diçka për të cilën unë s'ia kam idenë.

23 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Halling,
25 mund të na tregoni numrin maksimal të dokumenteve që mendoni

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 7

1 se mund të keni?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Një moment, i nderuar Gjykatës.

3 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

4 Z. HALLING: [Përkthim] Rreth dhjetë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe janë

6 dhjetë dokument nga një fletë, apo nuk e di a e dini?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk janë nga një fletë, po nuk

8 dokumente voluminoze.

9 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës

10 këshillohen]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

12 tregojmë fleksibilitet për këtë, mbase një pushim 30 minuta

13 deri në 40 minuta, supozoj se kjo do të jetë procedura

14 rezervë. Sepse ne duam që të kemi videolidhjen nëse është e

15 mundshme. Ky është objektivi që i kemi vetes. Por duam të kemi

16 dhe një plan rezervë.

17 Në bazë të kësaj, atëherë dhe në bazë të pëlqimit që ju

18 dhatë dhe pasi dëgjuam palët, tani do të lëshoj një urdhër

19 gojarisht për kërkesën për dëshminë me videolidhje për

20 dëshmitarin e dytë ekspert, numër 1253.

21 Më 7 janar 2022, Paneli i Gjykatës së Apelit e ktheu pas

22 një pjesë të vendimit të këtij Trupi Gjykses dhe lejoi

23 dëshminë e dëshmitarit të dytë ekspert në bazë të kufizuar.

24 Më 11 janar 2022, duke pasur parasysh vendimin e apelit

25 dhe atë çka bëri të ditur zoti Cadman se zoti dëshmitari

1 dëshiron të dëshmojë përmes videolidhjes, Trupi Gjykes bëri
2 të ditur se do të lëshojë një vendim në bazë të një kërkesë të
3 mëparshme për videolidhje për këtë dëshmitar. Ishte kërkesa me
4 numër F436.

5 Zyra Administrative ka bërë një vlerësim për
6 razueshmërinë e kësaj videolidhjeje ku ka bërë të ditur se të
7 paktën dy punonjës të Zyrës Administrative duhet që të
8 udhëtojnë për të shkuar në Australi dhe se kërkohet marrja e
9 masave komplekse përpara se të vihet në punë një videolidhje
10 të tillë. Zyra Administrative ka theksuar gjithashtu se duke
11 pasur parasysh kufizimet e tanishme mbi udhëtimet në Australi
12 dhe kërkesat lokale për karantinë, nuk do të jetë në gjendje
13 që të dërgojë staf në vendndodhjen e dëshmisë nëse nuk jepet
14 përjashtim.

15 Ky qëndrim është përditësuar këtu në sallë më 13 janar
16 kur Zyra Administrative ka bërë të ditur se po shikojnë
17 mundësi të tjera për vendosjen e videolidhjes me përfshirjen e
18 autoriteteve lokale pa pasur nevojë që personeli i Zyrës
19 Administrative të shkojë në vend. Kjo, kërkon një kohë të
20 konsiderueshme për të bërë koordinimin me autoritetet
21 kompetente për të vendosur në vend dhe instaluar pajisjet për
22 të gjetur një vendndodhje të përshtatshme dhe për të siguruar
23 mjedisin e videolidhjes.

24 Zoti Cadman, parashtroi se kërkesa për videolidhje
25 mbështetet në vështirësitë e tanishme për udhëtim, nevoja që

1 dëshmitari ka nevojë të bëjë karantinë kur të kthehet dhe që
2 ka një datë të planifikuar për vaksinim. Trupi Gjykues vëren
3 se dëshmitari ka bërë të ditur se nuk mund të udhëtojë në
4 Holandë nga periudha 24 deri në 31 janar, pra, nuk ka zgjidhje
5 të lehtë në këtë rast.

6 Trupi Gjykues vëren se sipas rregullit 144, paragrafi 1,
7 vendimi për të lejuar apo jo dëshminë me videolidhje është në
8 diskrecion të Trupit Gjykues duke pasur parasysh që vendi i
9 përzgjedhur dhe teknologjia e disponueshme të përputhë
10 kriteret e atij rregulli. Trupi Gjykues është në dijeni se
11 dëshmia me videolidhje nuk duhet konsideruar vetëm në bazë
12 përjashtimore. Megjithatë, prania në këtë sallë gjyqi e
13 dëshmitarit gjatë dëshmisë duhet të vazhdojë të jetë opsioni i
14 preferuar.

15 Trupi Gjykues, në këtë rast, mund të mbajë parasysh një
16 sërë faktorësh siç është vendndodhja, situata personale dhe
17 shëndetësore, disponueshmëria dhe siguria e dëshmitarëve si
18 edhe kompleksiteti dhe kohëzgjatja e masave logjistike të
19 udhëtimit dhe të tjera që duhen bërë.

20 Për këtë kërkesë, Trupi Gjykues ka peshuar, nga njëra anë
21 situatën personale të dëshmitarit, vështirësitë për udhëtim
22 dhe mungesën e disponueshmërisë për të udhëtuar për në Hagë
23 dhe nga ana tjetër kohën e nevojshme për të marrë masat e
24 nevojshme për pajisjet që është në anën tjetër të botës.

25 Organizimet me autoritetet lokal -- me asistencën e

1 autoriteteve lokale dhe diferencën në brezat kohor.

2 Trupi Gjykses ka marrë parasysh se vonesat do të cenonin
3 të drejtën e të akuzuarve për t'u gjykuar pa vonesë. Në
4 veçanti, Trupi Gjykses vëren se seanca e parë pas dëgjimit pas
5 janarit është data 21 shkurt, që do të përbënte një vonesë tre
6 javore sa i takon finalizimit të paraqitjes së provave nga
7 Haradinaj vetëm e vetëm për shkak të mosdisponueshmërisë së
8 një dëshmitari.

9 Në bazë të të gjitha këtyre, Trupi Gjykses konstaton se
10 opsioni më i arsyeshëm në këtë rast është që dëshmitari i dytë
11 ekspert të dëshmojë përmes videolidhjes ose një formë tjetër
12 të platformave online. Edhe pse është në diskrecion të këtij
13 Trupi Gjykses që të urdhërojë dëshmitarin që të paraqitet këtu
14 në sallë, në këtë rast, ka pasur parasysh që udhëtimi me
15 Australinë është shumë më i vështirë në krahasim me vendet e
16 tjera, Trupi Gjykses ka vendosur të mos i kërkojë dëshmitarit
17 të jetë në sallë.

18 Në të njëjtën kohë, Trupi Gjykses vëren edhe
19 kompleksitetin e detyrës për Zyrën Administrative dhe kohën
20 shumë të shkurtër që është në dispozicion.

21 Për këtë arsye, Trupi Gjykses urdhëron. Urdhërohet Trupi
22 Gjykses [sipas përkthimit] që të jetë i gatshëm datë 24 dhe 28
23 janar nga ora 8.00 e mëngjesit deri në orën 12 të drekës me
24 orën e Hagës, që është ora 5.00 deri në 9.00 në vendin ku
25 banon dëshmitari në Australi.

1 Trupi Gjykses është në dijeni që dëshmitari ka një
2 vaksinim të planifikuar për në datë 28, por duke qenë se kjo
3 është e vetmja datë tjetër e disponueshme kur ai mund të
4 dëshmojë, presim prej atij që të respektojë këtë kërkesë. Kjo
5 do të thotë se seancat në 24, 28 janar do të fillojnë në orën
6 8.00 të mëngjesit, do të bëjmë pushim duke filluar nga ora
7 9.30 dhe pastaj do të vazhdojmë edhe dy orë të tjera, nga ora
8 10.00 deri në orën 12.00 të drekës.

9 E di se kjo do të jetë më e vështirë për përkthyesit dhe
10 gjithë të tjerët e përfshirë në këtë, por është situata e
11 veçantë e kësaj shtate që kërkon fleksibilitet nga të gjithë.
12 Në rastin më të mirë, dëshmitari do të dëgjohe me videolidhje
13 në të dyja datat në përputhje me rregullën 144 dhe Direktivën
14 e Punës për Videolidhjet. Por, nëse videolidhja nuk mund të
15 organizohet deri më datë 24 apo deri më datë 28, dëshmitari do
16 të dëgjohe përmes platformës Zoom.

17 Trupi Gjykses e di se gjatë videos Zoom kjo -- dhënia e
18 dëshmisë përmes Zoom-it nuk është në përputhje me kushtet e
19 rregullit 144 dhe Direktivën e Punës për videolidhjet. Por
20 duke pasur parasysh vështirësitë dhe duke pasur parasysh edhe
21 zotimin e palëve që të mbajnë privat, me një fjalë që të mos
22 kenë seanca private ose të kenë sa më pak, atëherë Trupi
23 Gjykses mendon se kjo në formë përjashtimore është gjëja më e
24 mundshme.

25 Trupi Gjykses vëren se kjo nuk është objekt i kritereve

1 formale dhe s'po i bën devijim nga kriteret formale të
2 rregullit 144, çka që nuk do të përbënte cenim të asnjërës
3 palë.

4 Gjithsesi, Trupi Gjykues i udhëzon palët që të tregojnë
5 listën e prezantimit me - t'ia tregojnë pra dëshmitarit listën
6 e prezantimit përmes Zyrës Administrative. Për të bërë këtë
7 gjë i urdhërojmë palët që të dërgojnë listën e prezantimit
8 Zyrës Administrative në kohën e duhur përpara fillimit të
9 bërjes së pyetjeve nga ana e tyre, në mënyrë që Zyra
10 Administrative të mund t'ia dërgojë ato dëshmitarit sipas
11 afateve që vendos urdhri për zhvillimin e procesit.

12 Dëshmitari urdhërohet të mos nxjerrë asnjë informacion
13 konfidenciale nga këto dokumente dhe të mos dublikojë dhe të
14 mos ndajë me të tjetër dokumente në asnjë formë me një person
15 të tretë.

16 Urdhërohet Zyra Administrative që të informojë Trupin
17 Gjykues në ditët në vijim sa i takon progresit për masat që
18 duhet marrë. Këtë mund ta bëni përmes postës elektronike apo
19 mes telefonatave drejtuar nëpunësit tonë juridik.

20 Trupi Gjykues falënderon Zyrën Administrative dhe
21 autoritetet australiane për punën e tyre.

22 Këtu mbyllet ky urdhër i dhënë gojarisht.

23 Kam një urdhër tjetër gojarisht për kalendarin e
24 gjykimit. Kjo ka të bëjë me kalendarin për këto dy javë në
25 vijim.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 13

1 Trupi Gjykues pret që të dëgjojë këta dëshmitarë në këto
2 ditë.

3 Zotin Qalaj, Dëshmitari 1246, sot dhe nëse do jetë edhe
4 të hënën në datë 17 janar. Nëse dëshmia e zotit Qalaj mbaron
5 sot nuk do të zhvillojmë seancë të hënën.

6 Zonja Myers, që është Dëshmitare 1252, më 21 janar. Nëse
7 dëshmia e saj nuk përfundon në atë datë, do ta dëgjojmë
8 dëshminë e saj dhe më datë 24 janar në seancën e rregullt të
9 pasdrekes që do të zgjatet nëse është nevoja për ta përfunduar
10 dëshminë e saj.

11 Zoti Reid, që është Dëshmitari 1253, më datë 24 janar dhe
12 28 janar midis orës 8.00 të mëngjesit dhe orës 12.00 të
13 drekës, siç dhashë edhe urdhër.

14 Zoti Gashi, Dëshmitari 1254, më 31 janar.

15 Siç e thashë edhe më përpara, Trupi Gjykues u kërkon
16 palëve që ta informojnë menjëherë përmes nëpunësit tonë
17 juridik nëse ka ndryshime të cilat bëhet të nevojshme dhe ne
18 sinqerisht shpresojmë që s'do të ketë ndryshime.

19 Trupi Gjykues kërkon parashtrime nga palët në lidhje me
20 rregullat 127, 133, 134, 135, 156 dhe 159, paragrafi 6. Do të
21 lëshohet një urdhër me shumë gjasë javën e ardhshme. Këto
22 parashtrime do t'i marrim me shkrim ose gojarisht mbasi të
23 përfundojë paraqitja e provave nga Mbrojtja dhe në varësi dhe
24 të progresit që do bëjmë në javët e ardhshme.

25 Dhe në fund një urdhër gojarisht për parashtrimin e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 14

1 protokolluar F517, dorëzuar nga Prokuroria më 12 janar 2022.

2 Është një njoftim i ZPS-së, kundërshtim sipas rregullit
3 102(3), duke pasur parasysh që ky parashtrim i protokolluar ka
4 të bëjë vetëm me një material dhe argumentet e ZPS-së janë
5 paraqitur në mënyrë koncize, Trupi Gjykues mendon se është e
6 përshtatshme të shkurtohet afati për përgjigjen e Mbrojtjes.

7 Prandaj, urdhërohet Mbrojtja që t'i përgjigjet
8 parashtrimin F517, brenda të enjtes 20 janar 2022. Nuk do të
9 lejohen kundërpërgjigjet. Dhe këtu mbyllet urdhri i tretë i
10 lëshuar gojarisht.

11 Zoti Cadman, ju bëtë të ditur që dëshironi që ti bëni
12 pyetje plotësuese zoti Haradinaj. Keni parasysh që mund që ju
13 lejohet që ta bëni këtë vetëm për pyetje dhe çështje që kanë
14 dalë në kundrapyetjet. Kjo është sipas paragrafi 76 të urdhrin
15 për Zhvillimin e Procedurës.

16 Mund të vazhdoni.

17 Z. BOWDEN: [Përkthim] Shumë shkurt. Kolegia duhet të
18 largohet në orën 10.30. Thjesht desha ta informoj Trupi
19 Gjykues për këtë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

21 Zoti Cadman, keni fjalën.

22 DËSHMITARI: NASIM HARADINAJ [Vijon]

23 Kundërpyetje nga zoti Cadman:

24 Py. Mirdita, zoti Haradinaj.

25 Pë. Mirdita.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 15

1 Py. Prokuroria në mënyrë të përsëritur ka sugjeruar në
2 kundrapyetjet që ju ka bërë se ju kërkoni që ta pengoni këtë
3 Gjykatë. Për qenë shumë të qartë, kundërshtimin ju e keni ndaj
4 kësaj Gjykate apo ndaj politikës që ndjek Prokuroria?

5 Pë. Kundërshtimin e kemi vetëm ndaj qasjes që ka Prokuroria,
6 jo ndaj Gjykatës. Gjykatën e kuptoj si të mirëfilltë dhe të
7 rregullt dhe legjitime.

8 Py. Gjithashtu, keni thënë në dëshminë tuaj dhe që është
9 kundërshtuar nga Prokuroria, se doni që të procedohen këtu të
10 gjithë personat pavarësisht se kush janë. Pse është e
11 rëndësishme kjo për ju?

12 Pë. Është e rëndësishme sepse unë mendoj se çdo njeri që ka
13 kryer krim është meritator dhe e meriton dhe duhet të sillet
14 para drejtësie. Pse të seleksionohen këta?

15 Py. Dua që t'ju bëj një pyetje, zoti Haradinaj, a jeni në
16 dijeni të një incidenti që ka ndodhur më 28 shkurt deri në 1
17 mars 1998 që Çirez. A jeni pra, në dijeni të këtij incidenti?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtim. Nuk ka lidhje me
19 çështjet që ne kemi ngritur në kundrapyetje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A është
21 përmendur kjo gjatë kundrapyetjeve, zoti Cadman, ju kujtohet?

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Prokuroria ka ngritur çështje në
23 lidhje me konfliktin gjatë kundrapyetjeve që i ka bërë zotit
24 Haradinaj. Kështu që dhe unë kam më se të drejtë që të flasë
25 për çështje që kanë të bëjnë me çështje që kanë të bëjnë me të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 16

1 njëjtën periudhë kohore.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të
3 argumentoni më qartë se ku doni të arrini me këtë.

4 Z. CADMAN: [Përkthim] Patjetër, i nderuar Gjykatës. Dhe
5 kështu do të veprojmë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Para se të
7 bëhet pyetja.

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Do të përmend disa incidente të
9 cilat kanë ndodhur. Dua që ta pyes dëshmitarin nëse ka qenë në
10 dijeni të tyre.

11 E di, po puna është që mund të jap shumë informacione
12 sepse në një farë mënyre kjo do ndikonte.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni fjalën
14 për -- do të flisni për drejtësinë e luftës?

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Do ta pyes nëse është në dijeni të
16 disa incidenteve që kanë ndodhur gjatë konfliktit, si pjesë e
17 konfliktit. Nëse Prokurorisë i lejohet që të flasë për
18 incidente që kanë lidhje me aktivitetet të UÇK-së atëherë edhe
19 unë duhet të kem të drejtë që t'i përmend dëshmitarit
20 incidente për të cilat ka pasur apo jo dijeni lidhur me këto
21 gjëra. Pra, kjo ka të bëjë me gjendjen mendore dhe me pistën e
22 Mbrojtjes që ai ka paraqitur në dëshminë e tij dhe në
23 kundrapyetje.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Ne s'kemi përmendur asnjë incident
25 të tillë të akuzuarit. Nëse avokati e ka referencën në të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 17

1 kundërt mund ta përmend.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
3 përmendur ndonjë incident?

4 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nëse
5 Prokurorisë i lejohet që t'i përmendë dëshmitarit, të
6 pandehurit në këtë rast, aktivitete të UÇK-së dhe duke pyetur
7 nëse ai i mbështet nëse duhen procedura e tjerë, e tjerë.
8 Kështu që unë nga ana ime thjesht do ta pyes a është në dijeni
9 dëshmitari për këto incidente dhe për njohuritë që ka për
10 hetimin e tyre.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë nuk e di
12 se cila do jetë pyetja tjetër po unë po jua them që tani, që
13 drejtësia e luftës nuk ka lidhje me akuzat. Krimet serbe gjatë
14 asaj lufte gjithashtu nuk kanë lidhje me këtë çështje.

15 Nëse ju do bëni pyetje për interesin publik mund t'ju
16 japim një përkufizim të kësaj. Kjo ka të bëjë me hedhjen e
17 dritës mbi -- kjo nuk përfshin hedhje drite mbi krimet serbe
18 gjatë luftës. Kjo ka të bëjë me hedhjen e dritës mbi
19 papërshtatshmërinë e konfrontimit ose bashkëpunimit midis
20 Zyrës së Task Forcës dhe ZPS-së me autoritete serbe. Prandaj,
21 nëse ju do të flisni për incidente të kryera nga serbët, këto
22 nuk janë pjesë e kësaj çështje gjyqësore.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë nuk do t'i kërkoj, të pyes - që
24 të konfirmojë nëse janë kryer nga serbët apo jo. Thjeshtë do
25 ta pyes për disa incidente. Të shikoj disa emra nga një listë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 18

1 dhe ta pyes nëse beson se nëse ndonjë prej këtyre individëve
2 nga ajo listë ka qenë të përfshirë në kryerjen e këtyre
3 krimeve.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe cila
5 është baza e dijenisë së tij?

6 Z. CADMAN: [Përkthim] Po thjesht do ta pyes nëse ka
7 dijeni.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë ju thashë
9 sesi do të vazhdojmë. Mund t'i bëni pyetje.

10 Zoti Haradinaj, nuk do t'i përgjigjeni asnjë pyetjeje
11 nëse nuk i është dhënë mundësia zotit Halling, pra,
12 Prokurorit, të kundërshtojë ose jo dhe pastaj do të vazhdojmë
13 me përgjigjen.

14 Z. CADMAN: [Përkthim]

15 Py. Zoti Haradinaj, a jeni në dijeni të një incidenti që ka
16 ndodhur më datë 28 shkurt deri më 1 mars që quhet -- që njihet
17 si masakra e Çirezit?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk thatë
19 vitin.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Viti 1998. Që njihet si masakra e
21 Çirezit. Përpara se të përgjigjeni do të lexoj një listë
22 datash sepse pyetja është e njëjtë në lidhje me të gjitha këto
23 data.

24 Më 1 prill 1999 dhe më 25 maj 1998, në dy incidente të
25 ndryshme që është masakra e Lubeniqit; më 15 janar 1999, ai

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 19

1 çka është njohur që tani njihet si masakra e Reçakut; më 5
2 mars 1999, një sulm kundër Prekazit në të cilin forcat serbe
3 vranë Adem Jasharin dhe 60 anëtarë të familjes së tij; dhe më
4 27 prill 1999, ajo njihet si masakra e Mejës, ku 300 shqiptarë
5 dyshohet se janë vrarë nga forcat serbe.

6 A mund të shihni tani listën e emrave.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fillim
8 pyeteni a ka dijeni? A është në dijeni të atyre? Po përgjigja
9 "po" ose "jo".

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Me përgjigje "po" ose "jo". A jeni
11 në dijeni të këtyre incidenteve të cilat sapo jua lexova?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Bëjmë kundërshtim. Nuk ka lidhje.
13 Lidhet me krimet gjatë konfliktit. Po kështu është një pyetje
14 orientuese.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë dua që ta
16 dëgjoj përgjigjen. A jeni përgjigj po ose jo. Jeni në dijeni?

17 I AKUZUARI HARADINAJ: Po. Jam në dijeni. Disa jam në
18 dijeni --

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Kaq
20 mjafton. Kaq mjafton.

21 Mund të vazhdoni të bëni pyetjen.

22 Z. CADMAN: [Përkthim] A mund ta shihni tani listën e
23 emrave, pa i përmendur emrat, a mund të më thoni nëse besoni
24 se ndonjë prej këtyre personave të kësaj liste kanë qenë të
25 përfshirë në ndonjë prej këtyre masakrave?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 20

1 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtim. Nuk ka lidhje me
2 kundrapyetjet.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
4 kundërshtimi.

5 Z. CADMAN: [Përkthim]

6 Py. Në këtë proces gjyqësor, zoti Haradinaj, keni dëgjuar
7 dëshminë e një dëshmitareje të Prokurorisë zonja Zdenka
8 Pumper, e cila i ka konfirmuar Trupi Gjykses se Prokuroria nuk
9 po heton kryesit serbë të krimeve. Mund t'ju pyes si ju bën
10 kjo ju që të ndiheni?

11 Pë. Jo vetëm unë që ndihem keq, po të gjithë çka janë në
12 Kosovë dhe shpresoj jo vetëm shqiptarët, po të gjithë ata të
13 cilët duan drejtësi ndihen keq. Unë mendoj që ndihen keq edhe
14 serbët edhe nacionalitetet e tjera sepse kanë viktima nga të
15 gjithë.

16 Py. A mund t'ju kërkoj që të konfirmoni se gjatë shtatorit
17 2020, a keni pasur dijeni në qoftë se ndonjë prej atyre
18 incidenteve ka qenë duke u hetuar?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Hedh poshtë
20 kundërshtimin e Prokurorit.

21 Mund të përgjigjeni zoti Haradinaj.

22 I AKUZUARI HARADINAJ: Jo, nuk kam pasë dijeni. Edhe unë
23 s'kam as deri sot dijeni. Ende kam bindjen se s'janë duke u
24 hetuar ato.

25 Z. CADMAN: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 21

1 Py. Zoti Haradinaj, kur i keni pa këto emra apo disa prej
2 këtyre emrave në materialin që keni parë në shtator të vitit
3 2020, si ju bëri që të ndiheni ajo?

4 Pë. Mua m'u kujtu menjëherë drejtësia që ishte në kohën e
5 Millosheviçit komplet dhe e dita që këtu nuk kemi shansa.
6 Përpos që ka qenë arbitrare kam mëndu që është edhe
7 politikisht e ndikune sepse ashtu ishin ato drejtësi. Dhe kjo
8 më ngjante ashtu dhe ashtu e ndjej. E ndjeja dhe prandaj edhe
9 kam reagu.

10 Py. Dhe në bazë të asaj që sapo thatë, a mund të konfirmoni
11 në qoftë se ajo ishte arsyeja, pra, a ishte interesi publik
12 për ato që tani thatë që ju drejtoj që të bëni atë që të bëni?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Pyetja është orientuese.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po pajtohem.
15 Riparafrazoni pyetjen.

16 Z. CADMAN: [Përkthim]

17 Py. Në bazë të asaj që patë dhe në bazë të asaj që thatë zoti
18 Haradinaj dhe në bazë të asaj, domethënë, që keni parë, çfarë
19 ishte arsyeja për veprimet që ndërmoret? Cila ishte arsyeja?

20 Pë. Zoti avokat, krejt kjo për çka unë kam bo dhe po akuzohem
21 këtu, arsyeja pse unë nëse kam bo këto dhe krejt sa kam bo ka
22 qenë vetëm transparenca dhe interesi publik. Asgjë tjetër. Dhe
23 të përçoja apo të tregoja sesi po ndihemi edhe ne si veteran
24 edhe opinionin publik. Në fund të fundit unë e kam dhënë jetën
25 për qet popull dhe për qet të mirë dhe për demokracinë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 22

1 Prandaj kur shoh që m'u kanë shkel këto, kjo ka qenë për hir
2 të transparencës dhe interesit publik. Asnjë send tjetër. Dhe
3 njëanësisë që ka kjo Prokurori.

4 Py. Prokuroria dje ju tha se ju e keni publikuar këtë
5 material. Pyetja ime është kjo. A e keni publikuar ndonjë prej
6 materialeve që u soll në zyrën tuaj në shtator të vitit 2020?
7 Pë. Zoti avokat, po më vjen keq që duhet me ju drejtu edhe
8 ty, po më duket nuk e paske ndi. Gjatë dy ditëve me radhë e
9 kam cek për ju dhe për të gjithë të pranishmit këtu, se
10 asnjëherë, në asnjë çast dhe në asnjë fletë dhe asnjë sekondë
11 nuk kam publiku dhe nuk kam fotografu as me telefon as kurrëgjë
12 vetë personalisht.

13 Py. Dje, gjatë kundërpyetjeve të Prokurorisë në lidhje me
14 këtë pikë -- apo ta bëj kështu pyetjen: A mendoni se ka ndonjë
15 dallim midis fjalës publikim dhe bërje publike?

16 Pë. Po. Në varësi se në cilin kontekst e thua.

17 Py. Dhe fraza që përdorët ju, a mund t'ju pyes a e përdorët
18 fjalën publikim apo bërje publike?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk e kemi kontekstin se në çfarë
20 e ka përdorur dëshmitari këtë frazë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
22 qartësoni pak pyetjen, në mënyrë që t'a pranojë kundërshtimin.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Dje përmendët frazën për atë
24 intervistë "publikim". A mendoni që kjo është ndryshe nga
25 bërja publike --

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 23

1 Z. HALLING: [Përkthim] Zoti Gjykatës, zoti Haradinaj ka
2 thënë shumë gjëra dhe nuk e kemi videon specifike për të cilën
3 bëhet fjalë këtu.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
5 ju keni kërkuar nga Prokuroria që të jenë specifike atëherë
6 dhe ju vetë duhet të jeni specifik, zoti Cadman.

7 Z. CADMAN: [Përkthim] Në rregull.

8 Py. Dje nga fundi i kundërpvetjeve zoti Haradinaj, po ju pyes
9 kështu: Në qoftë se -- sikur për shembull t'ju ish dhënë
10 material që ju mendoni se është në interes të publikut, a do
11 ta kishit bërë përsëri të njëjtën gjë?

12 Pë. Unë prandaj thashë. Unë prandaj i thashë edhe Prokurorit
13 kur më pyeti vetë në fund se a do t'i bëni. Unë nuk e di se
14 këto sende a janë ma interes publik që ka ndodhë. Po nëse
15 është interes publik është edhe detyrë për transparencë dhe
16 interes publik. Është detyrë e çdo qytetari nëse a interes
17 publik. Prandaj kur më pyeti Prokurori se a do t'i bëni më,
18 unë nuk dashta të paramendoj ose të qesë atë se çka do të
19 ndodhë se këto gjana unë nuk besoj që mbas dy vite që janë më
20 interes publik këtu. Nëse është ndonjë interes tjetër, normal.
21 Ne e kemi betimin, detyrën me i bo interesin publik. Çdokush.
22 Çdo qytetar është obligim moral, transparenca dhe interesi
23 publik. Unë mendoj që janë të lejueshme dhe obligative të them
24 në atë mënyrën morale për secilin njeri.

25 Py. Dhe a do t'i kishit nxjerrë të dhënat e dëshmitarëve.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Nasim Haradinaj (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 24

1 Pë. Në asnjë mënyrë, sepse nuk është punë e jona ajo. Nuk
2 është punë e jona ajo. Për ne ka qenë në interes publik po
3 edhe në interesin tonë vetëm me u tregu çka na ka ardhë, jo
4 çka ka në brendi.

5 Py. Ju faleminderit, zoti Haradinaj. Nuk kam pyetje të tjera
6 për ju në këtë moment. Nuk e di në qoftë se anëtarët e Trupit
7 Gjykues do të kenë pyetje për ju.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Buckley?

9 Z. BOWDEN: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni,
11 zoti Bowden.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
13 zoti Haradinaj. Përfunduat me dëshminë tuaj. Mund të uleni tek
14 vendi juaj dhe do t'ju shoqëroj ndihmësi deri aty.

15 I AKUZUARI HARADINAJ: Ju faleminderit.

16 [I akuzuari largohet]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A doni të
18 thoni diçka për hir të procesverbalit zoti Cadman? Të ulemi
19 njëherë që t'i pastrojmë tavolinat e punës.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Pikërisht këtë desha ta kërkoj. Më
21 duhen pesë minuta që të përgatitem për dëshmitarin e ardhshëm.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Mbeti një pikë procedurale që duam
24 t'a përmendim për hir të procesverbalit në qoftë se lejoni, i
25 nderuar Gjykatës.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Urdhëroni
2 zoti Halling.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Ka të bëjë me dëshmitarin që është
4 i caktuar për të dhënë dëshmi me 21 janar 2022. Është me
5 rëndësi që ajo të fillojë dhe të përfundojë dëshminë e saj
6 brenda asaj dite. Ne mund të kemi kundërshtime në lidhje me
7 pranueshmërinë e disa provave varësisht se kur do të paraqiten
8 ato për pranim. Dhe është në interes të ecjes së shpejtë të
9 procesit, prandaj duam që të na jepni një indikacion se çfarë
10 provash ka ndërmend të përdorë me atë dëshmitar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta
12 bëni këtë, zoti Cadman?

13 Z. CADMAN: [Përkthim] Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
15 për bashkëpunimin,

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Vetëm një pikë në lidhje me këtë
17 deklaratë. Me sa duket deklaratata origjinale ka qenë në listën
18 e prezantimit për zotin Gucati dhe ka një numër DH.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni fjalën
20 për deklaratën e zotit Qelaj?

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Po. Po përpiqem ta gjej.

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] A mund t'ju ndihmoj për këtë,
23 zoti Cadman. Është dokumenti me numrin ERN DHG0148 deri në
24 DHG0150.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A jeni gati,

1 zoti Cadman?

2 Z. CADMAN: [Përkthim] Po.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani

4 dëshmitari i ardhshëm do të sillet në sallë.

5 Zoti Cadman, vetëm një moment. Dëshmitari i ardhshëm ka
6 pyetur në qoftë se mund ta sjellë me vete deklaratën dhe don
7 të sjellë edhe shënime.

8 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nuk ka njoftuar paraprakisht për
9 këtë kërkesë për të sjellë shënime. Në qoftë se don ta bëj
10 këtë atëherë duhet të le.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka nevojë
12 që të sillen shënime sepse nuk e dimë se për çfarë janë ato
13 shënime. Nuk ka nevojë që dëshmitari me vete të marrë asnjë
14 gjë.

15 [Dëshmitari hynë në sallën e gjyqit]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të uleni
17 për momentin, zoti Cadman.

18 Zoti Qalaj, mund ta nxirrni maskën dhe t'i vendosni
19 dëgjueset. A më dëgjoni?

20 DËSHMITARI: Po.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistentja

22 tani do t'ua japë tekstin e deklaratës solemne që prej jush do
23 të kërkohet ta bëni në përputhje me rregullin 141(2) të
24 Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

25 Ju lutem, lexoni deklaratën me zë.

1 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
2 dhe përgjegjësinë time ligjore deklaroj solemnisht se do të
3 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe
4 nuk do të mbajë të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

5 DËSHMITARI: RASHIT QALAJ

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
7 Mund të uleni.

8 Do ta zgjas edhe pak, zoti Cadman.

9 Zoti Qalaj, sot do të dëgjojmë dëshminë tuaj. Ju e di se
10 së pari pyetjet do t'ju bëjë zoti Cadman, do t'ju bëjë pyetje
11 lidhur me deklaratën tuaj dhe me ndryshimet që i keni bërë.
12 Gjykata do të nxjerrë një urdhër të shkurtër në lidhje me
13 deklaratën tuaj dhe me shtojcën dhe pas kësaj ajo pjesë e
14 dëshmisë suaj do të pranohet si provë në procesverbal.

15 Pas asaj do t'ju bëjë pyetjet zoti Cadman.

16 Më pas, avokati që përfaqëson zoti Gucati mund të ketë
17 pyetje për ju. Dhe pastaj pyetje do t'ju bëjë Prokuroria. Në
18 fund pyetje mund të ketë edhe Trupi Gjykses. Zoti Cadman ka
19 thënë që për afërsisht do t'i duhen 15 minuta për pyetjet e
20 tij. Mbrojtja e zotit Gucati ka treguar se do t'i duhen 30
21 minuta. Kurse Prokurorisë rreth dy orë.

22 Paneli mund të mundësojë pyetjet plotësuere sipas
23 nevojës.

24 Ju lutem përpiquni të përgjigjeni në mënyrë të qartë dhe
25 me fjali të shkurtra. Duhet të vini në dukje bazën e njohurisë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 28

1 tuaj në lidhje me faktet dhe rrethanat për atë që ju pyetet.

2 Ju lutem flisni në mikrofon dhe prisni rreth 5 sekonda
3 përpara se të përgjigjeni. Flisni ngadalë në mënyrë që
4 përkthyesit të mund t'ju përkthejnë.

5 Gjatë kohës që jepni dëshmi në këtë Gjykatë nuk ju
6 lejohet që përmbajtjen e dëshmisë suaj ta diskutoni me askënd.
7 Në qoftë se ndonjë person jashtë kësaj Gjykate ju bën pyetje
8 lidhur me dëshminë tuaj, ju lutem, të na informoni.

9 Zoti Cadman, së pari ju lutem pyetni dëshmitarin në qoftë
10 se deklarata e tij dhe ndryshimet që i ka bërë e reflektojnë
11 në mënyrë të qartë dhe të saktë atë që do ta thotë në Gjykatë
12 dhe pastaj duhet të kërkonit që ato të pranohen si prova.

13 Mund të vazhdoni.

14 Z. CADMAN: [Përkthim] Ju faleminderit, i nderuar
15 Gjykatës.

16 A do të kërkoj që zotit Qalaj t'i jepet versioni në shqip
17 i deklaratës së tij në mënyrë që ta ketë përpara. Është prova
18 me numrin DHG0148. Dhe versioni në anglisht mban numrin
19 DHG0181 deri në DHG0183.

20 Pyetje nga zoti Cadman:

21 Py. Zoti Qalaj, a mund të kërkoj prej jush të më konfirmoni,
22 në qoftë se e keni përpara, që kjo është deklarata juaj?

23 Pë. Nuk e kam përpara.

24 Py. Më fal, atëherë vetëm një moment, të lutem.

25 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk mund ta hapni. Kërkoj falje, i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 29

1 nderuar Gjykatës. Shtojca është vendosur në listën e provave
2 që do të prezantoheshin dje dhe si duket dokumenti nuk është i
3 qasshëm. Është ende më duket në listën e prezantimit për zoti
4 Gucati dhe nuk është vënë në këtë listë prezantimi.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të na thoi se
6 për cilën listë prezantimi e keni fjalën konkretisht.

7 Z. CADMAN: [Përkthim] E kemi referencën DHG dhe numrin që
8 na e dha zonja Bolici, përpara se të fillonim dhe ai është
9 versioni në shqip. Më falni.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po a kemi
11 kopje të shtypur të deklaratës? A është e mundur që
12 dëshmitarit t'i jepet një kopje e shtypur në mënyrë që të
13 identifikojë atë si deklaratë të vetën? Nuk e di në qoftë se
14 kjo është e mundur?

15 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
16 këshillohen]

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Do të na duhen 10 minuta për ta
18 bërë këtë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [E
20 padëgjueshme] Atëherë do të bëjmë një pushin të shkurtër prej
21 10 minutash.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 --- Pauza fillon në orën 10.22

24 --- Seanca rifillon në orën 10.39

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi gati që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 30

1 të vazhdojmë?

2 Z. CADMAN: [Përkthim] Thjesht dua të them që po vendosen
3 në një listë të veçantë prezantimi, ndërkohë që flasim do të
4 jenë të gatshme, por tani kemi kopje që mund t'ia vëmë në
5 dispozicion zoti Qalaj. Ju falënderoj për kohën që na vutë në
6 dispozicion. Falënderoj zoti Bowden.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të bëjmë
8 hapa pozitivë që kjo mos të vazhdojë të ndodhë më në të
9 ardhmen.

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Patjetër.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni shumë
12 punonjës dikujt mund t'i ngarkohet kjo detyrë. Mund të
13 vazhdoni.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
16 për durimin, zoti Qalaj. Nuk e di nëse jua them emrin saktë?

17 Në rregull, zoti Cadman. Mund të vazhdoni.

18 Z. CADMAN: [Përkthim]

19 Py. Zoti Qalaj, mund t'ju pyes nëse e shihni tani deklaratën
20 tuaj?

21 Pë. Po.

22 Py. A mund të konfirmoni që kjo është deklaratë juaj?

23 Pë. Mund të konfirmoj që kjo është deklaratë ime.

24 Py. Ju lutem, kaloni në fund të deklaratës suaj dhe
25 konfirmoni që është nënshkrimi juaj.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 31

1 Pë. Mund të konfirmoj që është nënshkrimi im.

2 Py. Po, Faleminderit.

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Ju lutem, t'i tregojmë dëshmitarit
4 DNH0981 që është shtojca.

5 Py. Mund të konfirmoni atëherë, pra, nëse e shihni nëse këto
6 janë ndryshimet që ju keni kërkuar t'i bëhen deklaratës së
7 parë që sapo e konfirmuat?

8 Pë. Konfirmoj.

9 Py. A është nënshkrimi juaj ai që është në fund të faqes?

10 Pë. Është nënshkrimi im.

11 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Gjykatës në
12 përputhje me rregullin -- jo dua të bëj dhe një pyetje tjetër.

13 Py. Zoti Qalaj, a është kjo dëshmia që dëshironi të jepni
14 para këtij Trupi Gjykses?

15 Pë. Po. Konfirmoj që kjo është dëshmia që mund të jap para
16 këtij Trupi Gjykses.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Përmbajtja e kësaj deklarate dhe e
18 kësaj shtojce të kësaj deklaratës, janë të vërteta me aq sa
19 dini dhe besoni?

20 Pë. Konfirmoj që përmbajtja e kësaj deklarate është e vërtetë
21 me aq sa di unë në lidhje me të.

22 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në përputhje
23 me rregullin 154, kërkojmë që kjo deklaratë të pranohet në
24 provat gjyqësore.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit. ZPS-ja ka bërë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 32

1 kundërshtim më përpara për paragrafin 20-22 të deklaratës
2 origjinale. Shikojmë që pjesë të paragrafit 22 janë kaluar në
3 paragrafin (e) të shtojcës me numrin ERN DNH0980.

4 Ka dy arsye. Pikë së pari, paragrafët si janë shkruar
5 tani nuk janë të kuptueshme fillojnë me fjalën "Kam kërkuar të
6 njëjtën gjë", por duke mos pasur dhe fjalinë e parë nuk dihet
7 se çfarë është e njëjta gjë.

8 Dhe së dyti, për sa i takon përmbajtjes së paragrafit,
9 opinionimi i këtij dëshmitari sa i takon shkallës optimale të
10 pjesëmarrjes së policisë kosovare në arrestimet që bënë ZPS-
11 ja, nuk ka lidhje me këtë gjykim dhe dëshmitari nuk është
12 dëshmitar ekspert dhe nuk ka dhënë bazë faktike për vlerësimin
13 që ka shprehur aty.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
15 zonja Bolici.

16 Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja ka bërë kundërshtime dje
17 dhe i përsërit sot për paragrafët 20 deri në 22. Mbrojtja e
18 Haradinaj nuk dëshiron që të mbështetet në këto paragrafë me
19 përjashtim të fjalisë së fundit të paragrafit 22.

20 Trupi Gjykses përsërit konstatimet e bëra më përpara që
21 këto duket se janë -- se kjo dëshmi ka lidhje me regjimin
22 përkatës që ka të bëjë me shtytjen në kryerjen e krimit.

23 Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses vëren se fjalia në
24 kllapa siç tregon dhe Prokuroria ka kuptim vetëm në lidhje me
25 pjesën tjetër të paragrafit, pra, që është paragrafi 22. Trupi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 33

1 Gjykues gjithashtu vëren se paragrafi 22 lidhet nga larg me
2 paragrafët 13 dhe 17 të deklaratës dhe për këtë arsye shumë
3 pak mund të ketë lidhje me këtë procedurë.

4 Për këtë arsye, Trupi Gjykues e hedh poshtë kundërshtimin
5 e ZPS-së për paragrafin 22. Trupi Gjykues vëren se zoti Qalaj
6 është i pranishëm në Gjykatë dhe i gatshëm për kundrapyetje
7 dhe për pyetje nga Trupi Gjykues. Ai gjithashtu ka vërtetuar
8 se deklarata e tij me shkrim dhe shtojca e kësaj deklarate
9 reflekton në mënyrë të saktë ato që do thotë këtu në sallë
10 para Trupit Gjykues.

11 Prandaj Trupi Gjykues e pranon në prova gjyqësore
12 deklaratën me shkrim të zoti Qalaj në përputhje me rregullin
13 përkatës. Trupi Gjykues pranon dhe shtojcën e deklaratës në
14 tërësinë e vet. Ndërsa deklarata pranohet me përjashtim të
15 paragrafit 20, 21.

16 I kërkoj Sekretares t'i caktojë një numër.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,
18 deklarata DH00148 [sipas përkthimit] bëhet prova materiale 2D3
19 ndërsa shtojca me numër DNH0981 [sipas përkthimit] me numrin
20 294 [sipas përkthimit].

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prova 293
22 [sipas përkthimit] dhe 294 pranohen në provat gjyqësore.

23 Zoti Cadman, vërej se deklarata përmban një pjesë, pra,
24 përmban të dhëna për dëshmitarin. Dëshironi që të jetë publike
25 kjo apo do të përgatisni një version publik të redaktuar.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 34

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Do të përgatisim një version publik
2 të redaktuar.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Urdhërojmë
4 Mbrojtjen e Haradinajt që të dorëzojë në *Legal Workflow* brenda
5 datës 20 janar 2022, një version publik të redaktuar dhe
6 versionin anglisht të deklaratës në mënyrë që kjo të futet në
7 dokumentacionin dhe të regjistrohet në të njëjta prova
8 materiale dhe duke shënuar se redaktuar.

9 Shtojca do jetë publike.

10 Zoti Cadman, mund të lexoni disa pjesë të deklaratës për
11 procesverbalin pastaj mund të bëni dhe pyetje nëse keni.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Falenderojmë. Do ta lexojë zoti
13 Buckley.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Zoti Buckley, keni fjalën.

17 Z. BUCKLEY: [Përkthim] Deklarata lexon si në vijim.

18 Unë, Reshit Qalaj, i datëlindjes 15.08.1968 do të them si
19 në vijim.

20 Kam lindur në Mirashë, Ferizaj, të Kosovës.

21 I nderuar Gjykatës, nuk do ta lexoj adresën.

22 Prej vitit 2000 deri në 14 janar 2021 kam qenë anëtar i
23 Policisë së Kosovës. Gjatë kësaj kohe kam qenë në pozita të
24 ndryshme si polic patrulle, mbikëqyrës i ndërrimit në gardë,
25 rreshter, zyrtar në operativë, komandant stacioni, shef i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 35

1 zyrës operative si edhe drejtor i përgjithshëm i Policisë së
2 Kosovës.

3 Kam marrë pjesë në UÇK.

4 Nuk e njoh zotin Nasim Haradinaj personalisht po ai është
5 personalitet publik dhe e njoh si të tillë.

6 Gjatë periudhës 2 gusht -- gjatë periudhës 2019 deri në
7 tetor 2020 kam qenë drejtor i përgjithshëm i Policisë së
8 Kosovë.

9 Në lidhje me rrjedhjen e dokumenteve nga ZPS-ja, unë
10 personalisht jam informuar nga drejtori i Departamentit të
11 Hetimeve në Policinë e Kosovës - pasi që unë kam qenë jashtë
12 shtetit - ndërsa policia (hetuesit) e PK-së pasi kanë dëgjuar
13 nga mjetet e informimit apo dosjet, pra, se në Shoqatën e
14 Veteranëve të Luftës së UÇK-së janë sjellë dokumente apo dosje
15 që mund të jenë të rasteve të Prokurorisë të Gjykatës Speciale
16 në Hagë. Kanë shkuar në zyrat e shoqatës kanë kontaktuar me
17 zyrtarët e shoqatës dhe janë takuar. Në takim hetuesit e PK-së
18 janë informuar se personi apo personat e panjohur kanë sjellë
19 në zyrat e kësaj shoqate dokumente apo dosje që dyshohet që
20 mund të jenë të Prokurorisë apo Gjykatës Speciale në Hagë. Për
21 këtë arsye zyrtarë të shoqatës së UÇK-së kanë kërkuar nga
22 hetuesit e Policisë së Kosovës që të bashkëpunojnë dhe të
23 procedojnë apo hetojnë këtë rast dhe të identifikohet personi
24 që po sillte dosje në zyrat e shoqatës si dhe të merre në
25 menaxhim këto dosje.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 36

1 Pas kërkesës nga zyrtarë të shoqatës së UÇK-së bërë
2 hetuesve të PK-së që të procedojnë rastin për këto dosje është
3 komunikuar me Prokurorinë Speciale në Prishtinë nëse duhet të
4 procedonte apo jo Policia e Kosovës dhe a duhet të hapte rast.
5 Prokuroria Speciale në Prishtinë ka thënë se ky rast është
6 kompetencë e Prokurorisë Speciale në Hagë dhe se autoritet e
7 Kosovës nuk mund ta hetojnë këtë rast pa pasur kërkesë nga
8 Prokuroria Speciale në Hagë.

9 Ka një gabim shtypi në paragrafi 9. Në anglisht duhet
10 lexuar "nobody", pra, "askush".

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Në deklaratën time është, pra,
12 "askush".

13 Z. BUCKLEY: [Përkthim] Mbase ka problem formatimi në
14 deklaratën time.

15 Policisë së Kosovës nuk i është kërkuar nga askush që të
16 merret me hetimin e këtij rasti. Ndërsa sa i përket
17 Prokurorisë Speciale nuk e di dhe nuk jam kompetent që të flas
18 për të.

19 Ne, pra, Policia e Kosovës kemi marrë udhëzime nga
20 Prokuroria Speciale e Kosovës që të mos merremi me trajtimin e
21 këtij rasti.

22 Pas këtij njoftimi nga Prokuroria lokale në Prishtinë, se
23 Policia e Kosovës nuk mund të procedojë rast pa pasur kërkesë
24 nga autoritet e Hagës, Policia e Kosovës nuk vazhdoi që të
25 grumbullojë informata për të apo të identifikojë personin që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 37

1 dyshohet se po i sjellin dosjet në shoqatë.

2 Kontrollimi i kamerave të sigurisë nuk mund të bëhet pa
3 urdhëresë nga Gjykata.

4 Nuk janë ndërmarrë veprime hetuese për shkak se s'kemi
5 pasur autorizim nga Prokuroria. Policia e Kosovës me kërkesë
6 të shoqatës së luftës ka shtuar patrullimet mobile në atë zonë
7 gjatë orarit administrativ të punës nga ora 08.00 deri në orën
8 16.00.

9 Nuk e di se kush e ka informuar ZPS-në pas tri
10 konferencave për shtyp.

11 Me sa njohuri kam, askush nga Policia e Kosovës nuk ka
12 qenë ndonjëherë i pranishëm në zyrat e ZPS-së -- nuk ka qenë,
13 pra, në zyrat e OVL-së apo në zyrën e ZPS-së në Prishtinë.

14 Arsyeja pse Policia e Kosovës nuk i ka marrë këto
15 dokumente është se Prokuroria Speciale e Kosovës nuk ka
16 autorizuar që të fillojmë hetim.

17 Policia e Kosovës nuk ka qenë brenda gjatë bastisjes,
18 mirëpo ka bërë sigurimin e jashtëm (perimetrin e jashtëm) të
19 ndërtesës pasi që bastisja është bërë nga njësitë speciale të
20 EULEX-it dhe hetuesit e ZPS-së.

21 Pas dërgimit të tretë të dokumenteve, Policia e Kosovës
22 ka pasur kërkesë nga shoqatat e dalura nga lufta për sigurimin
23 e zyrave të tyre, mirëpo Policia e Kosovës siguron vetëm
24 objekte shtetërore të rëndësisë së veçantë siç është
25 Presidenca, Qeveria, ministritë dhe disa nga objektet e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 38

1 trashëgimisë kulturore dhe fetare ortodokse serbe.

2 Kam kërkuar, kërkoj ndjesë, mendoj se autoritet në Hagë

3 duhet që të angazhojnë autoritet -- duhet të angazhojnë

4 Policinë e Kosovës nga të gjitha arrestim-bastisjet pasi që

5 Policia e Kosovës është shumë profesionale. Po këtë e kanë

6 kërkuar dhe udhëheqësit e komitetit ekzekutiv të EULEX-it si

7 dhe udhëheqësit e misionit të EULEX-it dhe kanë kërkuar që

8 këtë kërkesë t'ua përcjellin autoriteteve të ZPS-së në Hagë sa

9 unë kam qenë drejtor.

10 Jam i gatshëm të shkoj në Gjykatë në Hagë për të dhënë

11 dëshmi.

12 Dhe nënshkrimi i zotit Qalaj.

13 Kaq ishte, i nderuar Gjykatës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Dua të sqaroj nja dy gjëra, i

16 nderuar Gjykatës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Thjesht për të qenë të qartë nuk ka

19 nevojë që të lexohet shtojca se te shtojcat janë bërë gjatë

20 leximit, ndryshimet, pra, janë bërë gjatë leximit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e kuptuam.

22 Z. CADMAN: [Përkthim]

23 Py. Zoti Qalaj, në deklaratë ju përmendni ZPS-në në Prishtinë

24 që ka komunikuar me Policinë e Kosovës. A mund të konfirmoni,

25 me aq sa dini ju, ka komunikuar nga ana e ZPS-së me Policinë e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 39

1 Kosovës --

2 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtim. A mundet të thotë se
3 cili është paragrafi?

4 Z. CADMAN: [Përkthim] Paragrafi numër 8.

5 DËSHMITARI: Hetuesit që cilët kanë qenë në zyrat e
6 Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të
7 Kosovës pasi që iu është bërë kërkesë nga zyrtarët e kësaj
8 organizate për hetimin e këtij rasti, për hapjen e rastit,
9 kanë kontaktuar fillimisht nëpërmjet zinxhirit komandues me
10 drejtorin e Departamentit për Hetime në Policinë e Kosovës i
11 cili pastaj ka kontaktuar me Prokurorin e Prokurorisë Speciale
12 të Kosovës, i cili ka qenë duke e zëvendësuar Kryeprokurorin e
13 Prokurorisë Speciale, meqenëse ai ka qenë i sëmurë, më duket
14 për shkak të pasojave të COVID-it. Dhe nga ai ka marrë
15 përgjigjen që Policia e Kosovës nuk mund të hetojë këtë rast
16 për shkak se ky rast bie nën kompetencat e Zyrave të
17 Specializuar këtu në Hagë.

18 Z. CADMAN: [Përkthim]

19 Py. Pa përmendur emrat e hetuesit të ZPS-së që ju përmendët,
20 a e dini emrin e hetuesit që ka komunikuar këtë informacion.

21 Pë. Sigurisht. I di emrin e hetuesit dhe emrin e prokurorit.

22 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mund të na
23 duhet që të kalojmë në seancë private që të marrë përgjigje në
24 pyetje. E kuptoj vështirësinë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [E

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 40

1 padëgjueshme] Do t'i tregoni diçka apo do bëni pyetje për një
2 emër.

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Sigurisht mundet por emri nuk është
4 shkruar. Nuk e dimë. Na vendos në vështirësi. E kemi të
5 vështirë që ta bëjmë pyetjen.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
7 Mettraux, e keni transkriptin ende?

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po.
9 një alternativë do të ishte që avokati t'i kërkoj dëshmitarit
10 ta shkruante emrin vetë në një copë letër.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë mund
12 t'i -- kjo është mënyra më e thjeshtë. Mund t'i jepni një copë
13 letër dhe ta shënojë pastaj për identifikim. Nëse ka më shumë
14 sesa një emër mund ta mbajë -- apo më shumë se një pyetje mund
15 ta mbajë atë copë letër dhe ta përdorë për të dyja.

16 Mund t'ia lini tani aty.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Po. Një moment.

18 Py. Jam tek paragrafi 8 i deklaratës. A mund të konfirmoni që
19 këta persona i thanë Policisë së Kosovës që të mos hetojë?

20 Pë. Në fakt, duke iu referuar paragrafit 8 të deklaratës
21 sime, zyrtarët e Organizatës e Veteranëve të Luftës të
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë kërkuar nga Policia e
23 Kosovës që ky rast të hetohet. Pra, të iniciohet rasti dhe ky
24 rast të hetohet nga Policia e Kosovës dhe Prokuroria e
25 Kosovës. Ndërsa përgjigja që është marrë pas konsultimit nga

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 41

1 drejtori i Departamenteve për Hetime me Prokurorin e
2 Prokurorisë Speciale përgjigja është që Policia e Kosovës të
3 mos të hapë rast dhe të mos hetojë për shkak se është
4 kompetencë e Prokurorisë Speciale këtu në Hagë.

5 Py. Dhe atëherë, a mund t'ju kërkoj që të konfirmoni se
6 komunikimi që e përmendët erdhi nga këto dy emrat e njëjtë që
7 i shënuat pak përpara?

8 Pë. Po, sigurisht.

9 Py. T'i kthehemi paragrafit 10 të deklaratës suaj. A mund të
10 kërkoj prej jush që të konfirmoni aty ku përmendni Zyrën e
11 Prokurorit të Specializuar që jep udhëzime, këto a erdhën nga
12 të njëjtat emra që janë në atë listë?

13 Pë. Po, është e vërtetë. Pra, paragrafi 10, të gjitha
14 udhëzimet që janë ardhur nga Prokuroria Speciale i janë
15 transmetuar drejtorit të Departamentit për Hetime dhe pastaj
16 policëve që kanë qenë në zyrat e veteranëve të luftës.

17 Py. Në paragrafi 11, të deklaratës suaj, ku thoni, pas
18 njoftimit nga prokuroria lokale në Prishtinë, a mund të
19 konfirmoni se cilin e keni parasysh kur thoni Prokuroria
20 lokale në Prishtinë? Për cilën e keni fjalën?

21 Pë. Fjalën e kam për Prokurorinë Speciale të Kosovës.

22 Py. Dhe a mund të kërkoj prej jush që të konfirmoni nëse
23 informacioni që përmendni në paragrafi 11, vjen nga të njëjtët
24 persona që janë të shënuar në këtë letër?

25 Pë. E konfirmoj.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 42

1 Py. Dhe a mund të kërkoj prej jush që të konfirmoni sesi ju
2 vetë e mësuar atë informacion, si kuptuat për atë informacion?

3 Pë. Unë në deklaratën time e kam potencuar se që nga data 7
4 shtator deri më 13 kam qenë në pushim dhe për disa ditë kam
5 qenë jashtë vendit dhe për këto ngjarje jam informuar nga
6 drejtori i Departamentit për Hetime.

7 Py. A mund t'ju pyes kështu, përgjithësisht, në qoftë se keni
8 pasur mundësinë që të punoni me forcat ndërkombëtare në Kosovë
9 dhe jashtë Kosovës më përpara në të kaluarën domethënë?

10 Pë. Unë që nga momenti kur jam bërë polic në Policinë e
11 Republikës së Kosovës, e dini që fillimisht policia ka qenë e
12 udhëhequr nga policia ndërkombëtare e UNMIK-ut, pra, nga
13 misioni i UNMIK-ut dhe tërë kohën deri në dy-tre vitet e
14 fundit kemi punuar ngushtë me kolegët tanë të misioneve të
15 ndryshme që u kanë qenë në Kosovë. Fillimisht me policët e
16 misionit të UNMIK-ut që kanë qenë në Kosovë e pastaj edhe me
17 kolegët nga misioni EULEX që ende sot gjinden në Kosovë edhe
18 pse me kompetenca shumë më të vogla edhe po ashtu edhe me
19 pjesëtarët e forcave të KFOR-it që janë forca ushtarake të
20 Kosovës që gjenden në Kosovë.

21 Py. Dhe duke mbajtur parasysh këtë përvojë, a ju ka ndodhë
22 ndonjëherë apo është normale që ju të udhëzoheni që të mos e
23 hetoni çështjen e kësaj natyre?

24 Pë. Jo. Edhe në të kaluarën ka pasur, sidomos në vitet e para
25 të krijimit të Policisë së Kosovës, ka pasur raste kur rastet

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 43

1 janë hetuar vetëm nga policia e UNMIK-ut mirëpo në atëkohë
2 Policia e Kosovës nuk ka pasur kapacitete të zhvilluara që të
3 merret me raste për shkak se ka qenë në formim e sipër. Mirëpo
4 që nga shpallja e pavarësisë e tutje në të gjitha rastet apo
5 në shumicën e rasteve ka qenë Policia e Kosovës ajo që është
6 marrë në shumicën e rasteve së bashku me kolegët tanë
7 ndërkombëtarë. Dhe kjo është hera e parë që Policia e Kosovës
8 nuk ka pasë as edhe një komunikim të vetëm me Dhomat e
9 Specializuara që janë këtu në Hagë.
10 Py. Ju faleminderit, zoti Qalaj. Nuk kam më pyetje për ju.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [e
12 padëgjueshme].

13 Dokumenti ku shënoi emrat duhet të nënshkruhet prej
14 dëshmitarit, t'i vendohet data dhe pastaj të paraqitet si
15 provë.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] A mund ta shohim?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
18 tregojani zotit Bowden dhe pastaj zonjës Bolici.

19 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
20 këshillohen]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa për të
22 informuar të gjithë. Kjo do të skanohet dhe do të futet në
23 sistem dhe do të jetë në dispozicion të palëve brenda disa
24 minutash.

25 [E padëgjueshme].

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 44

1 Sekretare caktoni numrin e provës.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti i shënuar nga
3 dëshmitari në sallën e gjyqit do të marrë numrin e provës 2D5.
4 Pra, edhe njëherë dokumenti që ka shënuar dëshmitari në sallën
5 gjyqit duhet të marr numrin e provës 2D5.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë prova
7 2D5 pranohet si e tillë.

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Kam edhe një pyetje të fundit, të
9 nderuar Gjykatës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

11 Z. CADMAN: [Përkthim]

12 Py. Zoti Qalaj, pasi pashë këto dy emra që i keni shënuar për
13 të konfirmuar thjesht se janë, domethënë, përfaqësues të Zyrës
14 së Prokurorisë Speciale të Kosovës në Prishtinë, a është kjo e
15 saktë? Këto dy emra, pra.

16 Pë. Jo. Emrat e parë janë policët të cilët kanë qenë në
17 Organizatën e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të
18 Kosovës, ndërsa emri i tretë është emri i prokurorit që është
19 kontaktuar në lidhje me këtë rastin.

20 Py. Dhe me sa dini ju më së miri, a e dinit se prej kujt ata
21 i morën ato udhëzime?

22 Pë. Policët i kanë marrë udhëzimet nga drejtori i
23 departamentit për Hetime i cili e ka kontaktuar Prokurorin në
24 Prokurorinë Speciale të Kosovës dhe nga ai i kanë marrë këto
25 udhëzime.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Cadman

Faqe 45

1 Py. Dhe a mund të konfirmoni apo të na e thoni datën se kur
2 janë dhënë ato udhëzime.

3 Pë. Udhëzimet janë dhënë më datën 8 shtator 2020.

4 Py. Dhe në fund, gjatë kësaj periudhe kohore, pra, derisa
5 ende shërbenit në Policinë e Kosovës, a keni pasur ndonjë
6 kontakt me Zyrën e Prokurorit të Specializuar këtu në Hagë apo
7 me ndonjë përfaqësues të asaj zyre në Prishtinë?

8 Pë. Sa për sqarim, unë kam pasur disa takime me partnerët
9 tanë ndërkombëtar me të cilët punon Policia e Kosovës, me
10 ICITAP-in, me OSBE-në e posaçërisht me udhëheqësin e misionit
11 të EULEX-it në Prishtinë. Dhe nga shumë tema që kemi diskutuar
12 kemi diskutuar edhe çështjet e Dhomave të Specializuara këtu
13 në Hagë dhe kam kërkuar që në çdo rast nëse ka ndonjë vendim
14 nga Dhomat e Specializuara për ndonjë operacion, për ndonjë
15 bastisje, për ndonjë arrestim në Kosovë me këto të m'Erret
16 Policia e Kosovës gjithmonë duke u bazuar që në bazë të ligjit
17 mbi Policinë e Kosovës, Policia e Kosovës është institucioni i
18 vetëm në Republikën e Kosovës i cili merret me zbatimin e
19 ligjit, me ofrimin e sigurisë dhe po ashtu edhe me zbatimin e
20 urdhëresave të gjykatave nga Gjykatat e Kosovës. E gjithmonë
21 duke konsideruar se edhe Zyra e Specializuar këtu në Hagë e
22 cila është formuar me vendim të kuvendit të Kosovës, po a
23 gjithmonë e kemi konsideruar që është Gjykatë dhe e
24 konsiderojmë që ë gjykatë e Kosovës, ka qenë baza e kërkesës
25 sime që Policia e Kosovës të mirret me çdo aktivitet të cilat

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Bowden

Faqe 46

1 rrjedhin nga Zyrat e Specializuara këtu në Hagë. Dhe gjatë
2 kësaj kohe, nuk kam pasur ndonjë kontakt, absolutisht të
3 vetëm, asnjë bisedë telefonike, asnjë komunikim me shkrim.
4 Mirëpo të vetmin komunikim që më ka thirrë dikush në telefon
5 ka qenë një ditë pasi që është arrestuar zoti Haradinaj, pra
6 nëse s'gaboju ka qenë data 26 shtator.

7 Py. Dhe ky është kontakti i vetëm që e keni pasë me këtë zyrë
8 domethënë gjatë gjithë kohëzgjatjes të këtyne ngjarjeve në
9 shtator të 2020?

10 Pë. Po e konfirmoj. Ka qenë kontakti i vetëm dhe ajo thirrje
11 telefonike ka qenë falënderim për bashkëpunimin, për ofrimin e
12 asistencës më datën 25 shtator atëherë kur policia në Kosovës
13 është angazhuar që të menaxhojë turmën që ishte mbledhur para
14 zyrave të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë
15 Çlirimtare të Kosovës.

16 Py. Ju faleminderit, zoti Qalaj. Nuk kam më pyetje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

18 Zoti Bowden.

19 Z. BOWDEN: [Përkthim] Kam dy pyetje për të sqaruar dy
20 aspekte.

21 Pyetje të palës tjetër nga zoti Bowden:

22 Py. Zoti Qalaj, në lidhje komunikimin, çfarë komunikimi ka
23 qenë ky? A ka qenë nëpërmjet telefonit, me email, domethënë,
24 si është bërë ai komunikim?

25 Pë. E keni fjalën për thirrjen telefonike më 26 shtator? Pra,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Bowden

Faqe 47

1 ka qenë thirrje në telefon.

2 Py. Jo. Kërkoj falje. E kam fjalën për datën 8 shtator kur
3 ndodhi një komunikim midis Zyrës së Prokurorit Special në
4 Prishtinë dhe drejtorit të hetimeve. Pra, çfarë metode
5 komunikimi u përdor në këtë rast?

6 Pë. Ka qenë komunikim me telefon, sikundër në të gjitha
7 rastet tjera. Zakonisht policia fillimisht komunikon me
8 telefon me Prokurorët, po në këtë rast, meqenëse ka qenë rasti
9 shumë i ndjeshëm atëherë komunikimin e ka bërë drejtori i
10 Departamentit për Hetime në Policinë e Republikës së Kosovës
11 me Prokurorin që ka qenë duke zëvendësuar kryeprokurorin e
12 Prokurorisë Speciale.

13 Py. Domethënë të gjitha komunikimet kanë qenë nëpërmjet
14 telefonit?

15 Pë. Po. Saktë.

16 Py. Edhe një sqarim në lidhje me paragrafin 11 të deklaratës
17 suaj. Fjalja e fundit fillon me fjalët "por edhe pas pak
18 ditësh jemi njoftuar se Prokuroria Speciale në Hagë ka
19 autorizuar hetues të Prokurorisë Speciale në Hagë që të hetojë
20 këtë rast dhe se Policia e Kosovës të mos procedojë me këtë
21 rast. A e dini se kush prej Zyrës së Prokurorit të
22 Specializuar -- a u identifikoi ndonjë emër prej zyrës së
23 Prokurorit të Specializuar në Hagë që kishte dhënë këtë
24 udhëzim?

25 Pë. Kjo mendoj që është hequr nga deklaratata ime dhe nuk

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 48

1 qëndron më si pjesë e deklaratës sime.

2 Py. E ke përmend një person, një individ me të cilin ka pasë
3 një farë komunikimi në zyrën lokale në Prishtinë. A ka qenë
4 edhe ndonjë person tjetër, ndonjë individ tjetër në Hagë që ka
5 komunikim me Policinë e Kosovës?

6 Pë. Po e përsëris edhe njëherë. Në asnjë rast të vetëm
7 Policia e Kosovës nuk ka komunikuar me asnjë zyrtar nga zyrat
8 këtu në Hagë. Përveç më 26 shtator kur unë jam thirrur në
9 telefonin tim nga dikush nga Prokuroria.

10 Py. Domethënë kur thoni pas pak ditësh jemi njoftuar atëherë
11 e keni fjalën për të njëjtin person që ju ka njoftu edhe më
12 përpara që ia keni shënu emrin?

13 Pë. Po, po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Tani do të vazhdojmë deri në orën 11.30 minuta dhe pastaj
16 do të bëjmë pushim.

17 Pyetje nga pala tjetër nga zonja Bolici:

18 Py. Zoti Qalaj, mirëmengjes. Unë jam Valeria Bolici dhe do
19 t'ju bëj disa pyetje.

20 Së pari, disa sqarime fundamentale.

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dua që dëshmitarit t'ia tregojmë
22 deklaratën e tij paragrafin 10, që është faqja DHG0182, tashmë
23 në ekran.

24 Py. Në deklaratë në atë paragraf thuhet:

25 "Ne, pra, PK-ja, kemi marr udhëzime nga Prokuroria

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 49

1 Speciale e Kosovës që të mos merremi me trajtimin e këtij
2 rasti".

3 Zoti Qalaj, kur thoni "Prokuroria Speciale e Kosovës" nuk
4 e keni fjalën për ZPS-në, pra, Zyrën e Prokurorit të
5 Specializuar në Hagë?

6 Pë. Jo, fjala është për Prokurorinë Speciale të Republikës së
7 Kosovës që gjendet në Prishtinë.

8 Py. Dhe që ta kenë të gjithë të qartë dhe për sqarim, zoti
9 Qalaj, ju e keni fjalën për Zyrën e Prokurorisë që ka
10 shkurtuesen SPRK dhe e cila nuk ka kurrfarë lidhje me Dhomat e
11 Specializuara të Kosovës; a është kjo e saktë?

12 Pë. E saktë.

13 Py. Në paragrafi 11 të deklaratës, ku thuhet:

14 "Pas këtij njoftimi nga Prokuroria lokale në Prishtinë se
15 Policia e Kosovës nuk mund të procedojë me këtë rast".

16 Përsëri e keni fjalën për SPRK-në, zoti Qalaj, jo për
17 ZPS-në, domethënë, Zyrën e Prokurorit të Specializuar në Hagë?

18 Pë. E konfirmoj që nuk kemi të bëjmë me ZPS-në. Mirëpo
19 gjithmonë i referohem Prokurorisë Speciale të Republikës së
20 Kosovës me seli në Prishtinë.

21 Py. Dhe a vlen e njëjta gjë edhe për paragrafi 17 të
22 deklaratës suaj që është nga fundi i faqes me numër DHG0182
23 dhe e keni përpara në versionin shqip, ku thuhet:

24 "Arsyeja pse PK-ja nuk i ka marrë këto dokumente është
25 pasi që nga Prokuroria Speciale e Kosovës nuk jemi autorizuar

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 50

1 që të fillojmë hetim".

2 Pra, edhe këtu e keni fjalën për Prokurorinë Speciale të
3 Republikës së Kosovës dhe jo për Zyrën e Prokurorit
4 Specializuar?

5 Pë. E saktë.

6 Py. Pra, për ta përmbledhur në pika të shkurtra, a është e
7 saktë se asnjëherë nuk keni marrë udhëzim prej vetë ZPS-së që
8 të mos hetoni rastin në lidhje me dorëzimin e dokumenteve në
9 zyrat e OVL UÇK-së?

10 Pë. Po, dhe po e them prapë. Në asnjë moment, asnjëherë, nuk
11 kemi marrë asnjë kërkesë nga Zyra e Prokurorisë së
12 Specializuar këtu në Hagë që të hetojmë apo mos të hetojmë
13 këtë rast.

14 Py. Faleminderit. Dhe në lidhje me tre emrat që i shënuat në
15 atë letrën, pa i përsëritur ju lutem, ju na thatë që dy emrat
16 e parë janë emrat e hetuesve kosovarë dhe se emri i tretë
17 është emri i një prokurori në Zyrën e Prokurorisë Speciale të
18 Kosovës. Ju e keni fjalën, pra për prokurorët e Prokurorisë
19 Speciale të Republikës së Kosovës dhe jo për prokurorë të ZPS-
20 së; a është kjo e saktë?

21 Pë. E saktë.

22 Py. Faleminderit. Domethënë, keni marrë udhëzime prej PSRK-së
23 që të mos ta hetoni rastin, pasi që PSRK-ja kishte vlerësuar
24 se nuk kishte juridiksion apo kompetencë për të hetuar apo për
25 të ndjekur penalisht këto pika lëndore; a është kjo e saktë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 51

1 Pë. E saktë.

2 Py. Ju faleminderit, zoti Qalaj. Tani do t'i referohem
3 paragrafit 11 të deklaratës suaj dhe dua të vë në dukje një
4 dallim midis asaj që keni thënë paraprakisht në deklaratën
5 tuaj të parë të datës 4 shtator 2021 dhe asaj që thoni në
6 paragrafi (b) të shtojcës që e keni nënshkruar dje dhe që ka
7 numrin e provës 2D4.

8 Në paragrafin 11 të deklaratës suaj të datës 4 shtator,
9 ju thoni që:

10 "Keni vazhduar të grumbulloni informata në lidhje me
11 materialet që i janë dërguar OVL UÇK-së edhe pasi që kishit
12 marrë udhëzime nga PSRK-ja që të mos mblidheni informacion të
13 tillë".

14 Në paragrafi (b) të shtojcës, ju thoni se:

15 "Menjëherë ndërpretë mbledhjet e informacionit dhe
16 identifikimit të personave pas marrjes së udhëzimeve prej
17 PSRK-së".

18 A mund të na e shpjegoni këtë dallim kaq të madh në
19 deklaratën tuaj, pra, midis asaj të parës dhe kësaj që thuhet
20 në shtojcë që është komplet e kundërta e asaj që është thënë
21 në deklaratën e parë.

22 Pë. Po. Mund ta shpjegoj pasi që në këtë paragraf është bërë
23 një lëshim teknik dhe nuk ka figuruar fjala "nuk", e cila,
24 normalisht, që ja ndryshon komplet kuptimin e këtij paragrafi.

25 Py. Zoti Qalaj, do ta lexoj pjesën e fundit të fjalisë së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 52

1 parë në paragrafin 11 kur thuhet:

2 "PK-ja ka vazhduar të grumbullojë informata apo të
3 identifikojë personin që dyshohet se po i sjellin dosjen në
4 shoqatë por nuk ka pasur informacion të verifikueshëm".

5 Dhe në paragrafin 11 të dokumentit 2D3 ju shtoni:

6 "Se disa ditë më vonë na informuan se zyra e Prokurorit
7 të Specializuar në Hagë kishte autorizuar hetuesit e Zyrës së
8 Prokurorit të Specializuar që të kryenin hetim në lidhje me
9 rastin dhe se KP-ja nuk duhet të procedojë me këtë rast".

10 Domethënë këtu si duket jepni më shumë të dhëna. Ju thoni
11 se ju keni vazhduar me hetimin pasi që keni marrë udhëzime që
12 të mos vazhdoni me hetimin dhe se informacioni që keni
13 mbledhur nuk ka mund të verifikohet. Ju gjithashtu thoni se
14 keni kontaktuar përsëri disa ditë më pas me PSRK-në dhe ju
15 keni marrë të njëjtin udhëzim në të njëjtin rast, pra, "nuk"
16 me sa duket, "nuk" është fjala që mungon -- vetëm një fjalë e
17 vogël. Nuk përputhet plotësisht me atë shpjegimin që sa na e
18 dhatë.

19 A mund t'ju lutem që të na e sqaroni këtë?

20 Pë. Jo, sqarimi i vetëm në lidhje me këtë paragraf është se
21 pas këtij njoftimi nga Prokuroria lokale në Prishtinë që kanë
22 -- nënkupton Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës në
23 Prishtinë, Policia e Kosovës nuk ka vazhduar që të mbledhë
24 informata për shkak se nga kjo Prokurori kemi marrë
25 instruksionet që të mos hapim rast për shkak se Prokuroria

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 53

1 Speciale e Kosovës nuk është -- nuk ka kompetenca dhe kjo
2 është kompetencë e Prokurorisë Speciale, pra, e Zyrave të
3 Specializuara këtu në Hagë.

4 Ndërsa në lidhje me këtë pjesën e fundit të paragrafit që
5 dhe kam kërkuar të hiqet, meqenëse, informatat në lidhje me
6 Prokurorinë Speciale të Zyrave të Specializuara këtu në Hagë
7 që ka autorizuar hetuesit, këto informata kanë qenë kryesisht
8 nga mediat dhe nuk kemi pasur ndonjë informatë zyrtare në
9 lidhje me këtë.

10 Py. Pra, Ju po na thoni se thjesht me gabim pa i kushtuar
11 vëmendjen e duhur, ju keni nënshkruar deklaratën ku konfirmoni
12 se keni vazhduar të mbledhni informacion edhe pse nuk jeni
13 udhëzuar që mos të vazhdoni me mbledhjen e informacionit. Kjo
14 është dëshmia juaj?

15 Pë. E nderuara Prokurore, e kuptoj natyrën e punës juaj, po
16 unë po e përsëris para Trupit Gjykues këtu dhe para të gjithë
17 atyre që janë duke shikuar, që Policia e Kosovës nga marrja e
18 instruksioneve nga Prokurori i Prokurorisë Speciale të
19 Republikës së Kosovës që të mos hapet rast, që të mos hetohet
20 ky rast më tutje për shkak që kompetent për hetimin e këtij
21 rasti janë autoritetet këtu në Hagë nuk ka vazhduar, po e
22 përsëris, nuk ka vazhduar që të mbledhë informata dhe që të
23 merret me këtë rast.

24 Py. Faleminderit, zoti Qalaj.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mendoj se është momenti i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 54

1 përshtatshëm për të bërë pushimin në qoftë se e keni ndërmend
2 ta bëjmë pushimin tani.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
4 pushim për gjysmë ore dhe pastaj do të vazhdojmë. Do të
5 përpiqemi të vazhdojmë.

6 Pushimi do të zgjasë deri në orën 12.00.

7 --- Pauza fillon në orën 11.29

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 --- Seanca rifillon në orën 11.59

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zonja Bolici,
11 mund të vazhdoni.

12 Ah po, nuk kemi ende dëshmitarin. Nuk mund të vazhdoni
13 dot atëherë.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
16 vazhdoni, zonja Bolici.

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
18 Py. Zoti Qalaj, në paragrafi 7 të deklaratës suaj, të cilën e
19 keni përpara, keni thënë se Policia e Kosovës - nga mediat [la
20 dëgjuar] se dokumentet janë sjellë tek shoqata e veteranë të
21 UÇK-së të cilat mund të kenë të bëjnë -- mund të kishin të
22 bënë, pra, me raste të Zyrës së Prokurorit të Specializuar,
23 ZPS-ja. A është e saktë që informacionin e parë që e mori
24 Policia e Kosovës ishte nga konferencat për shtyp që u
25 transmetuan më datë 7 shtator?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 55

1 Pë. Është e vërtetë. Është korrekt.

2 Py. Faleminderit, zoti Qalaj. Është po kështu e vërtetë që
3 askush nga Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së nuk e
4 ka kontaktuar Policinë e Kosovës nga ardhja e dokumenteve në
5 zyrën OVL UÇK-së deri në momenti kur u zhvillua konferenca për
6 shtyp; a është kështu?

7 Pë. Me sa unë kam njohuri Policia e Kosovës është njoftuar
8 nga mediat dhe nuk ka pasë ndonjë kontakt askush.

9 Py. Faleminderit. A është po kështu e vërtetë se askush nga
10 Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së nuk e kontaktoi
11 Policinë e Kosovës nga ardhja e paketës së dytë të dokumenteve
12 më datë 16 shtator deri në konferencën e dytë për shtyp që u
13 zhvillua po në të njëjtën ditë?

14 Pë. A ka mundësi të përsëritet pyetja edhe njëherë të lutem?

15 Py. A është e vërtetë se askush nga Organizata e Veteranëve
16 të Luftës së UÇK-së nuk e kontaktoi Policinë e Kosovës në
17 periudhën nga ardhja e dokumenteve për herë të dytë deri në
18 konferencën e dytë për shtyp që ka ndodhur më datë 16 shtator
19 2020?

20 Pë. Këtë nuk e di për shkak se Policia e Kosovës që nga rasti
21 i parë i rrjedhjes së dokumenteve, nuk është marrë më me këtë
22 çështje.

23 Py. Dhe me sa keni dijeni, ju nuk jeni kontaktuar nga
24 zyrtarët e OVL UÇK-së; kështu?

25 Pë. Me sa unë di, nuk jemi kontaktuar.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 56

- 1 Py. Dhe a është e vërtetë që askush nga Organizata e
2 Veteranëve të Luftës së UÇK-së nuk e kontaktoi Policinë e
3 Kosovës nga momenti që erdhën për herë të tretë dokumentet në
4 zyrat e OVL UÇK-së deri në zhvillimin e konferencës së tretë
5 për shtyp që u zhvillua më 22 shtator 2020?
- 6 Pë. Policia e Kosovës ka marrë një kërkesë me shkrim nga
7 shoqatat e dala nga lufta nga Organizata e Veteranëve të
8 Luftës, nga Shoqata e Invalidëve të Luftës dhe nga Shoqata e
9 Familjeve të Dëshmorëve të Rënë në Luftën e Ushtrisë
10 Çlirimtare të Kosovës më 6 tetor, në të cilën është kërkuar që
11 Policia e Kosovës të caktojë dy zyrtarë policor të qëndrojnë
12 afër zyrave të shoqatave të luftës, për shkak se, sipas
13 kërkesës së zyrtarëve të tyre, pas ngjarjeve që kanë ndodhë me
14 sjelljen e dokumenteve nga personi apo personat e ndryshëm,
15 këto shoqata e kanë ndjerë veten të kërcënuar dhe janë friguar
16 që mund të krijohet ndonjë incident dhe këtë kërkesë me shkrim
17 ja kanë drejtuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë së
18 Republikës së Kosovës, në këtë rast mua.
- 19 Py. Faleminderit, zoti Qalaj. Përmendët datën 6 tetor 2020.
20 Një kërkesë e tillë Organizata e Veteranëve të Luftës UÇK-së
21 nuk ia kishte bërë Policisë së Kosovës përpara kësaj date;
22 kështu?
- 23 Pë. Së paku ndonjë kërkesë e tillë nuk ka arrit në nivelin
24 tim, pra, nuk jam në njohuri.
- 25 Py. Faleminderit, zoti Qalaj. Më herët thatë se ju, pra,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 57

1 hetuesit e Policisë së Kosovës u paraqitët e zyrat e
2 Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së më datë 8
3 shtator 2020. Kjo u bë me nismën e Policisë së Kosovës, pra,
4 që shkuan aty hetuesit kosovarë?

5 Pë. Po, ka qenë iniciativë e Policisë së Kosovës që të shkojë
6 në zyrat e shoqatave të dala nga lufta. Askush nga Organizata
7 e Veteranëve të Luftës së UÇK-së nuk i kërkoi Policisë së
8 Kosovës që të paraqitej në zyrat OVL UÇK-së; kështu?

9 Pë. Jo, policët kanë shku brenda pas raportimeve që janë bërë
10 nga mediat në zyrat e veteranëve të luftës dhe janë takuar me
11 zotin Klinaku dhe stafin e tij. Dhe policëve ju është kërkuar,
12 po e përsëris edhe njëherë, që të hapin rast dhe të hetojnë të
13 gjithë këtë në lidhje me dokumentet që kanë ardhur për herë të
14 parë në këto zyra.

15 Py. Faleminderit, zoti Qalaj. A e dini nëse zyrtarë të
16 policisë së Kosovës ishin të pranishëm në zyrat e OVL UÇK-së
17 përpara apo pas dokumenteve që ishin ende në zotërim nga OVL
18 UÇK-ja të ishin sekuestruar nga ZPS-ja?

19 Pë. Hetuesit e Krimeve të Rënda të Policisë së Kosovës kanë
20 shkuar në zyrat e Organizatës së Veteranëve të Luftës pasi që
21 këto dokumente janë konfiskuar apo janë marrë nga hetuesit e
22 Dhomave të Specializuara.

23 Py. Faleminderit. Duke parë paragrafin 7 të dokumentit tuaj
24 fjalia e fundit, kur thoni që "Policia e Kosovës mori kërkesë
25 që të merrej me menaxhimin e këtyre dosjeve", për çfarë e keni

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Bolici

Faqe 58

1 fjalën në këtë pjesë të deklaratës?

2 Pë. Hetuesit policorë që kanë shkuar në zyrat e Organizatës
3 së Veteranëve të Luftës janë njoftuar nga zyrtarët e, në këtë
4 rast nga zoti Klinaku, se kopjen e vetme që e kanë pasur është
5 marrë, është konfiskuar nga hetuesit e Dhomave të
6 Specializuara këtu në Hagë. Dhe ajo çka unë kam menduar është
7 se po ashtu hetuesit janë njoftuar që disa kopje janë marrë
8 nga disa përfaqësues të mediave që kanë qenë në një konferencë
9 për media në këto zyra ato ditë.

10 Py. Në momentin kur hetuesit kosovarë shkuan në zyrat e
11 Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së në 8 shtator, a
12 kishte ende dokumente konfidenciale në mjediset e OVL UÇK-së?

13 Pë. Me sa unë e di, nuk ka pasë dokumente të tjera
14 konfidenciale.

15 Py. Po kur thoni që morët kërkesë që të merreshit me
16 menaxhimin e këtyre dosjeve, për çfarë bëhet fjalë këtu?

17 Pë. Ju referova atyre pohimeve të zyrtarëve të kësaj
18 organizate për dosjet që mund të jenë të marruna nga disa
19 përfaqësues të mediave në konferencën që ka qenë për shtyp.

20 Py. A mund të shpjegoni se çfarë lloj menaxhimi dosjesh e
21 keni fjalën këtu? Nuk jam shumë e qartë.

22 Pë. E nderuar Prokurore, ju e dini që po të hapte rast
23 policia e Kosovës dhe po të fillojke me hetimin e ardhjes së
24 këtyre dokumenteve në Organizatën e Veteranëve të Luftës,
25 njëra ndër veprimet e para që do të ishte, do të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 59

1 konfiskoheshin këto dosje, pavarësisht se ku gjinden.
2 Sigurisht, se me urdhër nga kompetentët e drejtësisë.
3 Py. Ju kuptoj. Do isha e saktë nëse do thosha që deri në
4 momentin kur Policia e Kosovës shkoi në mjediset e OVL UÇK-së
5 dosjet i ishin shpërndarë mediave dhe kopja e fundit ishte
6 sekuestruar nga ZPS-ja? Kështu që kjo është ajo që ka kuptuar
7 Policia e Kosovës?

8 Pë. E saktë.

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nuk kam më pyetje të tjera, i
10 nderuar Gjykatës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
12 Ndonjë gjë tjetër?

13 Z. CADMAN: [Përkthim] Dy pika shumë të shkurtra, nëse
14 mundem.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Në
16 rregull.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Shumë shkurt.

18 Pyetje vijuese nga zoti Cadman:

19 Py. Zoti Qalaj, për të qenë i qartë, Policia e Kosovës në
20 ndonjë moment a filloi ndonjëherë ndonjë hetim për këto gjëra?

21 Pë. Jo. Nuk kemi filluar hetim për shkak të instruksioneve të
22 qarta nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.

23 Py. Dhe a është e saktë nëse themi se për ta filluar këtë
24 hetim duhet që të merrnit udhëzim nga Prokuroria Speciale e
25 Republikës së Kosovës?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Cadman

Faqe 60

1 Pë. Është e saktë. Gjithmonë duke pasur parasysh se këto
2 raste janë ndijshme dhe gjithmonë duke e ditur, se dhe ne si
3 polici e kemi ditur, që këto raste bien në domenin e
4 përgjegjësive të hetuesve nga Dhomat e Specializuara këtu në
5 Hagë.

6 Py. Përmendët komunikimin që morët. Nëse mund të pyes Shoqata
7 e të Rënëve në Luftës së 6 tetorit, a është ky emri i
8 organizatës?

9 Pë. Kërkesa që i është bërë drejtorit të përgjithshëm të
10 Policisë së Kosovës ka ardhun në emër të tri organizatave që
11 janë të dala nga lufta çlirimtare e Ushtrisë Çlirimtare të
12 Kosovës, Organizata e Veteranëve të Luftës, Shoqata e
13 Invalidëve të luftës dhe Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të
14 Rënë në Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

15 Py. Data kur morët këtë, dua ta konfirmoj, ishte data 6
16 shtator apo 6 tetor.

17 Pë. Data e saktë kur drejtori i përgjithshëm e ka pranuar
18 këtë kërkesë është 6 tetor. 6 tetor 2020.

19 Py. Dhe mos mbase duhet të kishte kaluar një farë kohe, pra,
20 do t'i duhej një farë kohe kërkesës që të arrinte deri tek ju
21 si drejtor i përgjithshëm.

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kemi kundërshtim sepse kjo pyetje
23 kërkon spekulime.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Hidhet poshtë
25 kundërshtimi.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 61

1 Mund t'i përgjigjeni pyetjes.

2 DËSHMITARI: Tash varësisht prej mënyrës sesi e dërgojnë,
3 mirëpo tek unë në zyrën time ka ardhur më 6 tetor.

4 Z. CADMAN: [Përkthim]

5 Py. Pra, ekziston mundësia tërësisht e mundshme që mund të
6 jetë bërë më 6 shtator por deri tek ju ka arritur më 6 tetor?
7 Pë. Nuk e di. Nuk e di. Mirëpo unë mund të them që në zyrën
8 time ka arritur më 6 tetor, pra, nuk dua të spekuloj. Po
9 mënyra sesi e kanë dërguar shumë varet në cilët kanale e
10 dërgojnë, po zyrën time ka ardhë më 6 tetor.

11 Py. Faleminderit.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, faleminderit.
13 Nuk më pyetje të tjera.

14 Pyetje nga Trupi Gjykses:

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti Qalaj,
16 du atë jem i qartë. Nuk dua që të përsërisni të njëjtën por
17 edhe njëherë, në cilën datë e keni marrë urdhrin apo udhëzimin
18 nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës për të mos
19 hetuar?

20 Pë. Data e saktë është 8 shtator 2020.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thatë se e
22 dinit se kjo ishte pjesë e domenit të Zyrës së Prokurorit të
23 Specializuar të Hagës. Nga e dinit këtë?

24 Pë. Shkëlqesia juaj, ne e dimë që jemi një polici mjaft
25 profesionale dhe kemi bërë 20 vite përvojë dhe është shumë e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykues

Faqe 62

1 lehtë të dijet se çdo gjë që lidhet me hetimin e krimeve të
2 luftës që bien në domenin e Gjykatës Speciale që është këtu në
3 Hagë, e dimë që është në domenin e tyre. Ne nuk kemi qenë fare
4 të njoftuar, as sot nuk e di unë përmbajtjen e atyre
5 dokumenteve se çka kanë, përveç asaj që kam dëgjuar në media
6 ose dhe prej asaj që e kanë përcjellë gjykimin e zotit
7 Haradinaj dhe zotit Gucati.

8 Mirëpo ne si polici e Kosovës kemi qenë shumë të
9 kujdesshëm që të mos përziemi në kompetenca të institucioneve
10 të tjera edhe se gjithmonë, e thashë edhe njëherë, kemi
11 kërkuar nga partnerët tanë ndërkombëtarë, nga shefi i misionit
12 të EULEX-it që të jemi pjesë e procesit pavarësisht se çka
13 kërkohet nga Dhomat e Specializuar. Gjithmonë duke e ditur që
14 Policia e Kosovës është e aftë dhe ka kapacitete për të kryer
15 të gjitha detyrat që asaj i ngarkohen duke i ditur që misione
16 të tjera që janë në Kosovë kanë kapacitete të limituara dhe po
17 ashtu duke e ditur që policët e Kosovës janë ata që e dojnë më
18 shumë vendin se çdo kusht tjetër që mund të jetë në Kosovë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një pyetje të
20 fundit që ka të bëjë me pjesën e fundit që bëri zoti Cadman.
21 Më kërkesën e 6 tetorit që ju erdhi në zyrë, ju thatë që deri
22 tek u erdhi në datë 6 tetor?

23 Pë. E saktë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Normalisht
25 një kërkesë e një muaj i duhet -- një kërkesë për asistencë i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Rashit Qalaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykues

Faqe 63

1 duhet një muaj derisa të vijë në zyrën tuaj pas regjistrimit
2 në zyrën e policisë?

3 Pë. Po varësisht tash në kush e dërgon si e dërgon kërkesën.
4 Mirëpo në momentin që vjen kudo në ndonjë Stacion Policor të
5 Policisë së Kosovës rruga prej atij stacioni policor deri te
6 drejtuesi i përgjithshëm është shumë e shkurtër, që do të
7 thotë disa orë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
9 Unë kaq pyetje kisha.

10 Kolegët?

11 Gjykatësi Mettraux keni ndonjë pyetje?

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo.
13 Faleminderit, i nderuar Gjykatës, nuk kam pyetje.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtu mbyllet
15 dëshmia juaj. Ju falënderojmë. Mund të dilni tani nga salla e
16 gjyqit, asistentja e sallës do t'ju shoqëroj për të dalë.

17 DËSHMITARI: Faleminderit.

18 [Dëshmitari largohet]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kanë palët
20 ndonjë gjë për të ngritur sot?

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Asgjë të cilën ju duhet ta
22 shqyrtoni menjëherë. Por në fillim të kësaj jave, bëra një
23 diskutim me zotin Halling sa i takon paraburgimit.

24 Sigurisht, të nderuar Gjykatës do ta bëjnë rishikimin e
25 ardhshëm të paraburgimit në momentin e duhur duke qenë se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 64

1 çështje është ende pezull, pra, pa marrë vendim në apel. Kemi
2 rënë dakord për një shtyrje prej 10 ditësh të vendimit nga ana
3 juaj që t'i jepet mundësi marrjes së vendimit nga apeli siç
4 është vepruar edhe në çështjen numër 6. Ne nuk jemi kundër
5 kësaj metode pune.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë u
7 vendos në procesverbal, besoj se edhe zyra juaj mund të
8 vijoni.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Siç e kuptojmë ne duke qenë se
10 këto çështje kanë rëndësi edhe për rishikimin e ardhshëm të
11 paraburgimit, kërkon 10 ditëshin nga vendimi i apelit. Vetëm
12 se dua të them që Mbrojtja e Gucatit nuk ka bërë një apelim,
13 pra, nuk ka dorëzuar apelim por thjeshtë apelimi ka të njëjtat
14 çështje për të cilat është janë komentuar. Prandaj duam që nga
15 Mbrojtja e Gucatit të japin qëndrimin e tyre për çështjen e
16 paraburgimit.

17 Z. BOWDEN: [Përkthim] Po. Kjo ka kuptim dhe do të bëjmë
18 dhe ndryshimin përkatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
20 Atëherë do ta rifillojmë seancën më datë 21 janar në orën
21 9.30. Dëshmitare eksperte do të jetë atë ditë.

22 Gjë tjetër kanë palët? Në rregull.

23 Këtu ndërpresim seancën.

24 --- Seanca përfundon në orën 12.20

25